




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të dëgjimit publik me sportistët, rininë dhe OJQ-të, mbajtur më 26.08.2019, duke filluar në orën 14:00.

Të pranishëm ishin: Osman Bllaca, përfaqësues nga ekzekutivi, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Fitim Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Blerta Basholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës.

Diskutimin e hapi dhe e kryesoi përfaqësuesi i ekzekutivit, z. Osman Bllaca.

Osman Bllaca i përshëndeti të pranishmit dhe bëri të ditur se ai do t'i udhëheq diskutimet publike për hartimin e Kornizës afatmesme buxhetore për tri vitet e ardhshme, për vitet 2020 - 2022. Nga kjo kornizë do të nxirret buxheti për vitin 2020.

Për këtë takim është paraparë të flasim për identifikimin e kërkesave të sportistëve, rinisë dhe OJQ-ve për projektet, subvencionet për planifikim të buxhetit për vitin 2020.

Me ne janë edhe drejtoresha e Financave, Valbona Makolli, drejtoresha e Kadastrit, Valbona Osmani, drejtori i Investimeve Kapitale, Gëzim Mehmeti, drejtori i Sportit, Fitim Rexha, si dhe drejtoresha e Kulturës, Blerta Basholli.

Kjo është një metodë që do ta ndjekim, dhe e kemi ndjekur edhe viteve të kaluara, që është një lloj mekanizmi i drejtpërdrejtë i demokracisë, pasi që në këtë formë i përfshijmë edhe qytetarët në vendimmarrje, duke i inkorporuar kërkesat dhe nevojat e tyre nga ai komunitet apo nga ai aktivitet me çfarë ndërmerren ata, me qëllim që t'i plotësojmë.

Kuptohet se të gjitha kërkesat dhe nevojat nuk mund t'i zgjedhim, mirëpo ato të cilat janë më elementare, ato të cilat janë më me prioritet i inkorporojmë edhe në Kornizën afatmesme, edhe në buxhetin për vitin e ardhshëm.

Shaip Ademi shtroi çështjen e infrastrukturës, duke thënë se në Siçevë dhe Radashevc rrugicat kanë filluar të punohen, por është edhe një kanalizim, i cili ka ardhur nga Lluzhani deri në fshatin Halabak, fshatra këto të komunës së Podujevës, por ne jemi me komunë të Prishtinës, e që do të thotë se ky projekt ka mbetur në gjysmë. Tetë kilometra është traseja kryesore e kanalizimit që është bërë, kurse janë njëzet kilometra kanalizim që bëhen nëpër fshatrat e Komunës së Podujevës.

Që nga viti 2013, unë kam kërkuar që të bëhet edhe segmenti i vogël prej 1700 metrave, që diku as 40 mijë euro nuk kushton, e mos ta ndotim lumin. Lumë po e quaj, se ajo është përroskë e ujit që lidhet me lumin Llapi, dhe me e vazhduar atë projekt që nuk është aq i kushtueshëm.

Unë kam propozuar që të vijmë dhe ta shohim se si e ndotim ne, sepse të gjithë e kemi kanalizimin në të. Kam kërkuar kanalizimin nga Fusha e Pajtimit në Llukar, Grashticë, Makovc, por ky është i shtrenjtë. Vazhdimisht na është premtuar që do të kryhet vitin e ardhshëm, por kot presim. Ai projekt është i vogël, as 40 mijë euro nuk kushton, andaj kërkojmë që të fillojë gjatë këtij viti.

Qaq për këtë vit, kurse për vitin e ardhshëm desha ta potencoj se ne në Llukar e kemi një Shtëpi të kulturës që nga viti 1945, objekt i cili është i pashfrytëzueshëm dhe i rrënuar. Disa herë kanë qenë dy ish-drejtoreshat e Drejtorisë komunale të Kulturës, dhe kanë thënë se do ta paraqesim për vlerësim se a duhet rrënuar ai objekt i Shtëpisë së Kulturës, në mënyrë që të ndërtohet objekt i ri.

Lidhur me këtë çështje kisha propozuar që të organizohet një debat publik me banorët e këtyre fshatrave.

U përmend edhe plani zhvillimor për tri vjet. Që në vitin 2014 ka qenë një projektide për furnizimin e Gollakut me ujë të pijshëm. Për këtë kam diskutuar disa herë, dhe atje është paraparë Plani zhvillimor 2012 - 2022, që parashihet fillimi i saj. Unë e kam propozuar variantin që shkon nga Bardhoshi deri te shkolla e Siçevës me rënie të lirë, pastaj nga aty me e përcjellë në kodër të Sharbanit e me i furnizuar edhe pesë fshatra, ose me i gjetur liqenet nëntokësore të rrjedhshëm të ujit, që ka në Gollak mjaft të tillë, edhe ta furnizojmë popullatën me ujë të pijshëm.

Osman Bllaca tha se meqë kemi numër të vogël të qytetarëve pjesëmarrës, mundmi me i inkorporuar, pasi që është edhe drejtori i Shërbimeve Publike dhe drejtori i Investimeve Kapitale, por kërkesa më reale ishte ajo për Shtëpinë e kulturës, pasi që është e pranishme drejtoresha e Kulturës dhe mund ta identifikojë dhe ta marrë me prioritet.

Tani a do bëhet vitin që vjen apo në tri vitet e ardhshme, do e shohim edhe ne.

Jetullah Beqiri, drejtor i Ansambllit të këngëve dhe valleve "Prishtina", bëri të ditur se qyteti i Prishtinës dikur ka pasur nëntë ansamble, ku kanë qenë të angazhuar më se 900 anëtarë, ndërsa sot, për fat të keq, kemi vetëm këtë ansambël, të cilin unë e drejtoj, i cili ka diku 135 anëtarë, në tri gjenerata. Sa i përket mbështetjes, falënderoj Drejtorinë e Kulturës për subvencionin, me të cilin na ka mbështetur me një shumë simbolike për festivalin e Sllovenisë, ku do ta përfaqësojmë Kosovën dhe Prishtinën ndërkombëtarisht në mesin e 3000 pjesëmarrësve, dhe për këtë i kemi bërë të gjitha përgatitjet.

Meqë jam goxha aktivist në fushën e kulturës, mund të konstatoj se ata të cilët mbajnë dhe zhvillojnë aktivitete në komunën e Prishtinës, i mbrojnë vlerat e kulturës, se sikur të kishin qenë serioz ata, do të ishin sot këtu në mbledhje, hiç më pak se nja 20-30 vetë që ju prijnë ansambleve, por, për fat të keq, ata e kanë përgjegjësinë e jo ju.

Sa i përket subvencioneve, e falënderoj Shërbimin e financave, që në mënyrë rekorde na i ka qitur mjetet, se kemi qenë shumë keq financiarisht. Po ashtu, komisioni i cili vendos për ndarjen e subvencioneve, të shikojë dhe kontrollojë cilat institucione kulturore që mbajnë në mesin e 30-40 -100-200 fëmijë a janë duke punuar apo nuk janë duke punuar. Pra, ai komision të vendosë në mënyrën më korrekte. Nuk themi të mos i ndihmojmë të tjerët, por ajo të jetë

sipas rezultateve që tregojnë. Neve na mungon një objekt për t'i arritur synimet tona, por sot nuk kemi as karrige me u ulur. E falënderojmë Komunën dhe nënkryetarin e komunës z. Muhedin Nushi, që na kanë mundësuar me ushtruar në atelje në Pallatin e Rinisë. Po të na jepte Komuna mbështetje logjistike, ne jemi të gatshëm të përgjigjemi për jetën kulturore për qytetin e Prishtinës. Në mungesë të objektit nuk po kemi as ku t'i vendosim instrumentet tona. Kemi edhe shumë mirënjohje që na janë dhënë, e që edhe ato nuk kemi ku t'i vendosim. Kisha kërkuar që, nëse ndahet pak buxhet, ndajeni në mënyrë më korrekte, ua ndani atyre që e meritojnë dhe e dëshmojnë me rezultate. Si Ansambël, ne kemi marrë pjesë në shumë festivale në vende të ndryshme të Evropës. Tani, nga 4 deri më 10 shtator jemi në Slloveni, dhe ne shkojmë pothuajse me veshje të shqyera, nuk kemi opinga, nuk kemi plisa, nuk kemi shamia nuk kemi asgjë nga ato që duhet t'i kemi. Prandaj, kërkesa jonë është që të na ndihmoni, të paktën të na e siguron një objekt, ku ne do t'i kryenim detyrat dhe obligimet që i parasheh ky ansambël.

Osman Bllaca tha se një ndër prioritetet që Komuna e ka marrë parasysh, është se ne e kemi rritur subvencionin edhe për fushën e kulturës, e veçmas për festivale, do të thotë diku 60% e buxhetit total ka qenë vetëm për festivale.

Komisioni për ndarjen e subvencioneve punën e ka zbatuar në përpikëri, ku dhe vetë unë kam qenë pjesëmarrës, e kemi bërë shpalljen prej dy ekspertëve, njëri i fushës përkatëse dhe tjetri i fushës civile, që e kemi shpallur me konkurs. Pra, në mungesë të mjeteve financiare nuk kemi mundur të ndajmë më shumë se 10.000 euro për këtë ansambël.

Sa i përket lokacionit për nevoja të ansambli, nuk kemi hapësira të mjaftueshme që do të ishin në shërbim të ansambilit. Sa i përket kërkesës për ndarje të mjeteve financiare, kërkesat e paraqitura do t'i kemi parasysh edhe në hartimin e buxhetit, po ashtu edhe në ndarjen e subvencioneve dhe në ato mundësitë të cilat ne i kemi.

Shaip Ademi shtroi çështjen lidhur me pronat e përbashkëta që janë nëpër çdo fshat, që ato prona të jenë në menaxhimin e Komunës, pra të bëhet urbanizimi i tyre, të bëhet rruga, kanalizimi dhe ndriçimi, dhe t'ia japë donatorëve të kryejnë punën e tyre qysh kishte me u bërë fshati bashkëkohor. Në Planin zhvillimor urban i kam propozuar rrugët se si do të duhet të ishin dhe si duhet lidhur fshatrat në mes veti, pasi që më është thënë se duhet të lidhen fshatrat në mes veti, gjë e cila është duke u bërë.

Kërkoj nga ekzekutivi që këto shqetësime t'ia përcjellin Kabinetit të Kryetarit, si dhe drejtorit, z. Genc Bashota, i cili është i informuar lidhur me rastin.

Osman Bllaca tha se ato prona janë të definuara, pra është pronë komunale dhe pronë që është në menaxhimin e AKP-së.

Tash për tash, Komuna nuk ka ndonjë projekt të cilin do ta ndërtonte në ato fshatra të Gollakut. Në fshatrat e Gollakut ka vetëm pronë komunale, nuk ka pronë që është në menaxhimin e AKP-së.

Gëzim Mehmeti tha se pyjet, fushat, brigjet, të gjitha këto janë në administrimin e Agjencisë së Pyjeve dhe nëse ndryshohet diçka për neve, do të jetë e mirëseardhur.

Sa i përket rrugëve, kanë mbetur edhe dy rrugë pa u përfunduar në zonën e Gollakut, rruga Stallovë - Zllashë dhe Zllashë - Prapashticë.

Jetullah Beqiri, banor nga fshati Keqekollë, kërkoi që në lagjet "Qelaj" dhe "Halilaj" të bëhet shtruarja e rrugës me asfalt.

Gëzim Mehmeti, drejtor, tha se vetëm kryqëzimet do t'i shtrojmë në asfalt, si dhe në ato rrugë të cilat shpijnë deri te ndonjë vendpunishte apo ku ka investime në blegtori. Aty ku nuk ka banorë, nuk do të investojmë në asfalt.

Jetullah Beqiri tha se po që se na e rregulloni rrugën, unë jam i gatshëm me investuar në Keçekollë, në fshatin tim, me 12 hektarë e gjysmë tokë që kanë mbetur djerrinë. Po ashtu, kërkoi të dijë se ansambli "Minatori" në Kishnicë, pasi që ai veç tani është i një komune tjetër, si do të kishte mundësi ta ndihmonte Komuna e Prishtinës..

Shaip Dushi, propozoi që për nder të Ditës së Çlirimit të Prishtinës të organizohet në patronatin e Komunës, një festival me shoqëritë kulturo-artistike të Prishtinës dhe fshatrave të kësaj komune. Po ashtu, shtroi pyetjen se si do të kishte mundësi që Komuna e Prishtinës ta ndihmonte ansamblin "Minatori i Ri" në Kishnicë, ku ai ansambël tani veç i takon Komunës së Graçanicës.

Jetullah Beqiri tha se sivjet është bërë një diçka e mirë në Komunën e Prishtinës për festa, pikërisht me koncertin që është mbajtur me filarmoninë, ku kanë qenë vepra të mëdha artistike. Ne jemi të gatshëm gjithnjë për të bashkëpunuar, dhe besoj se do të sjellim mrekulli për qytetin e Prishtinës, vetëm na mbështetni të paktën edhe moralisht, se jemi të gatshëm me bërë gjithçka.

Përfaqësuesja nga organizata që merret me shërbimet për karrierë, tha se kjo organizatë ka për qëllim mbledhjen dhe përpunimin e indikatorëve të tregut të punës, organizimin e sesioneve informuese për nxënës dhe prindër, përkrahjen e bizneseve për mundësi praktike për nxënës, d.m.th ndërlidhjen e edukimit me treg të punës dhe zhvillimin e shkathtësive të të rinjve.

Adrian Berisha, në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe të pjesës së Kabinetit të Kryetarit, tha se Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit e ka një zyrë, që thirret Zyra e karrierës, d.m.th. zyra gjendet në lagjen "Taslixhe" dhe funksionon tepër mirë, bashkëpunon veçanërisht me shkollat e mesme profesionale, por p.sh për OJQ-të, përveç bashkëpunimit me atë zyrë, kishte qenë e rrugës ndoshta me aplikuar për subvencionet që i shpall Drejtoria e Sportit, për arsye se kjo drejtori e ka edhe dikasterin e rinisë.

Komuna e Prishtinës me të gjitha platformat e saj, i informon qytetarët në ueb-faqen e saj dhe në Facebook.

Dëgjimi publik përfundoi në orën 14:50.